

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Paradoksi: Haga i dha 25 vite burgim Thaçit, ndërsa Millosheviçi e kishte dënuar 10 vite!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/paradoksi-haga-i-dha-25-vite-burgim-thacit-ndersa-mil-oshevici-e-kishte-d-i586489
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:06:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5a6a76142c744f2ee1dc761b7dbd69e120906e60c60c34227103bd9c96419f34
TEKSTI	9641f3238d8c2e07a6020304e3ec0b3b7760ae3c085eb1469ee9bda62d33da2f
PAMJA	29e8de68591d15fb45cd66361f01c5d5276d526aaa11205220a7b278c92b6d79

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b8109f28b3df0313e18f23ace4d40650a04a4d002f058d98dc3bd904a3c5ec43
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b8109f28b3df0313e18f23ace4d40650a04a4d002f058d98dc3bd904a3c5ec43>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English




ie Hashim, sot po te shkruaj si mikina Rama ne trupen qe gjykon mandatin e Ols Dados, prokurorin qe vete ia propozoi Presidentit Topi? Kosova do te vazhdoje te mbeshte fundit

Paradoksi: Haga i dha 25 vite burgim Thaçi, ndërsa Millosheviçi e kishte dënuar 10 vite!



16 Shtator 2026, 15:30Rajoni TEMA



Gati tri dekada para dënimit me 25 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë, Hashim Thaçi ishte dënua në mungesë edhe nga sistemi gjyqësor i Serbisë.

Në korrik të vitit 1997, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, e cila në atë kohë funksiononte nën autoritetin e Beogradit, kishte shpallur dënimin me 10 vjet burg për Thaçin. Autoritetet serbe e akuzonin për veprimtari që i cilësonin terroriste dhe për sulme kundër policisë e ushtrisë serbe.

Procesi ishte zhvilluar në mungesë të tij, në një periudhë kur Serbia i ndiqte dhe i dënonte veprimtarët shqiptarë që angazhoheshin për çlirimin e Kosovës. Thaçi, i njohur gjatë luftës me nofkën "Gjarpri", vepronte ilegalisht dhe lëvizte ndërmjet Kosovës e vendeve të tjera, duke iu shmangur arrestimit nga forcat serbe.

Vendimi i vitit 1997 lidhej me veprimtarinë e tij në organizimin e rezistencës së armatosur dhe me sulmet që autoritetet e Beogradit ia atribuonin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Serbia e trajtonte UÇK-në si organizatë terroriste, ndërsa për shqiptarët e Kosovës ajo përfaqësonte lëvizjen çlirimtare kundër represionit dhe sundimit serb.

Thaçi nuk e vuajti dënimin e shqiptuar nga gjykata e kontrolluar prej autoriteteve serbe. Dy vjet më vonë, ai doli në skenën ndërkombëtare si drejtues politik i UÇK-së dhe udhëhoqi delegacionin e Kosovës në Konferencën e Rambujesë.

Pas përfundimit të luftës, ai themeloi Partinë Demokratike të Kosovës, shërbeu si kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme, ndërsa më vonë u zgjodh president. Në shkurt të vitit 2008, si kryeministër, Thaçi e lexoi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Në nëntor të vitit 2020, ai dha dorëheqje nga posti i presidentit pas konfirmimit të aktakuzës nga Dhomat e Specializuara dhe u transferua në Hagë.

Sot, më 16 shtator 2026, Trupi Gjyqësor e dënoi atë me 25 vjet burgim për krime lufte, duke e shpallur të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Kështu, Hashim Thaçi është përballur me dy dënime në dy periudha dhe rrethana krejtësisht të ndryshme: fillimisht nga sistemi gjyqësor i Serbisë së Slllobodan Millosheviçit në vite '90 për veprimtarinë e tij kundër pushtetit serb dhe, pothuajse 30 vjet më vonë, nga Dhomat e Specializuara në Hagë për pretendimet lidhur me krimet e kryera gjatë luftës. /Java News

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

UÇK-së: Padrejtësi e papranueshme

14:50 Rajoni / 1 koment

Vendimi në Hagë, Daçiq: Aktgjykimi konfirmon pretendimet e Serbisë për UÇK-në

14:10 Rajoni / 3 komente

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, BE apel për përmbajtje: Drejtësia të vijojë pa ndërhyrje](#)

14:00 Rajoni / 7 komente

Osmani: UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë, dje, sot e përjetësisht

13:50 Rajoni / 7 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.